


EULEX-si
hedh poshtë
deklarimet e
Beogradit se
nuk ka nisma
për bisedime me
Prishtinën



KQZ shqyrtoi
përgatitjet
për mbajjen
e zgjedhjeve
lokale në
Kosovë



Kohën e fundit
është vërejtur
rritje e numrit
të serbëve që
duan të pajisen
me dokumente
të Kosovës



Faqe 4

Vetëm një javë
nga lansimi i
numeracionit të
ri 045, operatori
Vala ka shitur
14 mijë e 445
numra



Faqe 6

EDITORIAL



GRUPET
E INTERESIT

Ylber ALIU

infopress

Numër
1

Me vranësira
• temp. max. 34 °C
• temp. min. 18 °C



1.3908 USD 1.5144 CHF 0.87600 GBP 132.06 Lekë

GAZETË E PËRDISHME ♦ E MËRKURË 22.7.2009 ♦ 0.20 €, 50 LEKË

www.infopress-rh.com

NR. 988 ♦

2009 © INFOPRESS

KOSOVA PA VIZA NË 2010?

Liberalizimi i vizave, Kosova i thërret BE-së

- ♦ Qeveria premton angazhim maksimal në përbushjen e obligimeve që do të nxjerrë Komisioni Evropian për liberalizim të vizave
- ♦ Haqif Mulliqi: Fundi i vitit 2010 do t'i gjejë Kosovën, Shqipërinë dhe Bosnjën në një standard me këto tri vendet e tjera që tashmë i kanë hyrë procesit të liberalizimit të vizave
- ♦ Shoqëria civile ka përgatitur një apel drejtuar parlamentarëve të BE-së



Vijon
në faqen
3

JENNIFER ELLISON
Ellison:
"Nuk jam
shtatzënë"

Biondja Jennifer Ellison e cila është e njohur si prezantuese, aktore, modele dhe këngëtarë e suksesshme...

FAQE 21

Nënkryetari i LDD-së, Berim Ramosaj, qëndron ende pas idesë për bashkim me LDK-në

Ende beson në 'bashkim'

Vetë fakti që është hapur debat publik dhe ka zëra të arsyeshëm nga të dyja anët dhe nga shumica e elektoratit, tregon se projekt është në realizim e sipër, - ka thënë Berim Ramosaj, ideator i bashkimit LDK-LDD

Vijon në faqen 4



Njëzet tonë barna me afat të skaduar në Rahovec

Tonelata barnash pa afat

Barnat me afat të skaduar janë prej vitit 1999-2000 në depot e QKMF-së në Rahovec

FAQE 12-13

Rr. Azem Jasharica Arberia II – Prishtinë
E-mail: digitecinfo@yahoo.com
Tel. & fax: +381 38/244-285
Mob: +381 44/600-111
www.rikon-it.com

FAQE 21



**OJQ-të dhe interesë
nacional**

Shkruan: Avni Azemi

DEBAT

FAQE 8-9

**S'ka shoqëri
civile**

Shkruan: Agron Kryeziu



Roli i OJQ-ve në Kosovë

**MITSUBISHI
ELECTRIC**
AIR CONDITIONING SYSTEMS
Zona Industriale Vetsnik Prishtine . Tel : 038 602 609

dukagjini
insurance company

Më e mira
Sh. A. Birra PEJA
N. Basha 160, Peje
Tel: 039 432 661
Fax: 039 433 989
info@birrapaja.com
www.birrapaja.com

SIGURIA
COMPANIJA E SIGURIMEVE
www.ks-siguria.com
Tel.: +381(0) 38 248 848, 248 849
Fax.: +381(0) 38 248 850 . marketing@ks-siguria.com

Liberalizimi i vizave

Kosova i thërret BE-së

Qeveria premton angazhim maksimal në përbushjen e obligimeve që do të nxjerrë Komisioni Evropian për liberalizim të vizave

Haqif Mulliqi: Fundi i vitit 2010 do t'i gjejë Kosovën, Shqipërinë dhe Bosnjën në një standard me këto tri vendet e tjera që tashmë i kanë hyrë procesit të liberalizimit të vizave

Shoqëria civile ka përgatitur një apel drejtuar parlamentarëve të BE-së

**Fitim Uka
PRISHTINË, 21 KORRIK**

Kosova eshtë lënë jashtë procesit të liberalizimit të vizave nga ana e Komisionit Evropian. Jo pak politikanë ndërkombëtarë, analistë politikë dhe njohës të marrëdhënieve ndërkombëtare e kanë quajtur absurd vendimin e BE-së për të lënë jashtë këtij procesi Kosovën, Shqipërinë dhe Bosnjën. Në Kosovë një vendim i tillë i BE-së konsiderohet si vendim politik që nuk ka të bëjë absolutisht me angazhimin e Qeverisë së Kosovës. Nga ana

tjetër, Qeveria premton se me të marrë obligimet e parashtruara nga KE, do t'i plotësojë në kohën sa më të shkurtër që është e mundshme. Analistët thonë se fundi i viti 2010 do ta gjejë edhe Kosovën në procesin e liberalizimit të vizave, ndërkëq shoqëria civile ka përgatitur një apel drejtuar parlamentarëve të Bashkimit Evropian dhe liderëve evropiane që të shqyrtojnë çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën.

Qeveria premton sukses

Së fundi, disa parti politike opozitare kanë drejtuar kritika në adresë të Qeverisë për mosliberalizimin e vizave. Por, kjo vlerësohet si e pandershme nga ana e zyrtarëve qeveritarë. "Nuk është aspak e ndershme që të fajësitet qeveria për një proces që nuk pyjet absolutisht asnjë qeveri e vendit të rajonit, por që varet prej Komisionit Evropian", thotë zëdhënësi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Memli Krasniqi. Sipas tij, çështja e liberalizimit të vizave nuk ndërlidhet me vullnetin e një Qeverie. Përkundër kësaj, Krasniqi thotë se Kosova ka filluar tashmë me përbushjen e obligimeve teknike që me kohën të nisë një proces i liberalizimit të vizave.

"Janë arritur sukseset e dukshme dheni imbetet që pas studimit të fizibilitetit Kosova të ketë kapacitet kontraktual dhe nga aty më pas do të shihen edhe rekomandimet që vijnë nga Komisioni Evro-



pian dhe që përfshin një gamë të gjërë të sferave", sqaron Krasniqi. Kjo, shton ai, do të jetë një etapë e re e vlerësimt dhe më pas liberalizimit të vizave. Sido që të jetë, Krasniqi nuk pranon të japë ndonjë afat kohor, përgjatë së cilit, Kosova do të mund të kryente të gjitha obligimet që i vihen nga KE dhe të fitonte liberalizimin e vizave. "Ne po bëjmë një punë të madhe në këtë drejtim. Në momentin që marrim obligimet nga Bashkimi Evropian, do t'i përbushim sa më shpejt që të jetë e mundur", premton zëdhënësi Memli Krasniqi.

Nuk e meritan ata që iu liberalizuan vizat

Analisti politik, Haqif Mulliqi, thotë se problemi i mosliberalizimit të vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës nuk duhet të shihet nga prizimi i politikës ditorë, por nga një prizëm realist.

"Unë thjeshtë nuk besoj se Qeveria e Kosovës mund të ketë pasur çfarëdo mekanizmi për të detyruar Parlamentin Evropian që të ndërmarrë veprimin për realizimin e vizave. Në duhet të jemi realistë dhe ta themi që Kosova ka qenë jashtë procesit dhe nuk ka qenë brenda, ta themi kornizës së paraparë për liberalizim të vizave", thotë Mulliqi. Ai mendon se kjo që ka ndodhur është vërtet një ndjenjë e keqe, një ndjenjë braktisjes, por që në Kosovë nuk ka një faktor kujdestar për këtë gjë.

"Unë nuk mund të them se tri shtetet që shkojnë në pako për liberalizim të vizave e kanë merituar. Në veçanti Maqedonia dhe sidomos Serbia, këtë nuk e kanë merituar. Por, gjërat duhet t'i shohim ne nga këndvështrimi ynjë dhe Kosova zapo e ka nisur rrugën drejt liberalizimit të vizave", thotë për "Infopress", analisti Mulliqi. Duke analizuar faktin që për liberalizim të vizave në Bashkimin Evropian nuk përdoret e drejta e vetos, por respektohet vendimi i shumicës, Mulliqi thotë se Kosova, Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina do të shkojnë në pako. Por, edhe atëherë, sipas tij, Kosova do t'i bëhet një lloj favori, pasi që Kosova ende është në shtetformim edhe nuk e ka përbyllur gjithë procesin e rumbullakimit të vizave shtetërore që janë konform kushtetutës. Përkundër kësaj, Mulliqi thotë se me rastin e kandidimit në pako, do të vlefjë precedentit dhe Kosova nuk do të mbetet vrimë e zezë në Ballkanin Perëndimor. "Fundit i viti 2010 do t'i gjejë Kosovën, Shqipërinë dhe Bosnjën në një standard me këto tri vendet e tjera që tashmë i kanë hyrë procesit të liberalizimit të vizave", thotë Mulliqi.

Politika katastrofale

Ndërkëq, të martën edhe Shoqëria Civile e Kosovës, ka ngritur zërin ndaj 'përrashimit' të Kosovës nga procesi i liberalizimit të vizave. Kështu, Shoqëria Civile ka përgatitur një apel drejtuar parlamentarëve të Bashkimit Evropian dhe liderëve evropiane që të shqyrtojnë çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën, sepse në të kundërtën, kjo e fundit mund të shndërrohet në një "geto vizash" pa kurfarë rrugëdalje. Apelin sotëm drejtuar parlamentarëve evropiane e kanë nënshkruar rreth 18 persona, ndër ta edhe Rada Trajkovic, mënykretare e Këshillit Kombëtar të Serbëve të Kosovës; Nadira Avdiq-Vllasi, gazetare dhe udhëheqëse e Forumit të Boshnjakëve. Në një konferencë për gazetarë, Luan Shllaku, nga Fondacioni i Kosovës për Shqipëri të Hapur, duke lexuar apelin e përgatitur, tha se janë të shqetësuar se Kosova ka mbetur jashtë këtij procesi.

"Ne evropianët e brengosur që jetojmë në Kosovë, e mirëpresim propozimin e KE-së që t'i lejoj qytetarët e Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi të udhëtojnë pa viza në BE nga fillimi i viti 2010. Së shpejti shpresojmë që edhe Shqipëria e Bosnja do ta gjëzojnë një gjë të tillë, por shqetësoheni që Kosova ka mbetur jashtë këtyre proceseve", ka thënë ai. Shllaku ka thënë me bindje se Kosova i plotëson kushtet për të qenë pjesë e listës së bardhë të Shëngjenit, nëse për të qenë pjesë e listës së zezë nuk është dashur konsensusi. Ai ka thënë po ashtu se qytetarët e Kosovës janë të vetëdijshëm që shtetet anëtare të BE-së nuk pajtohen në lidhje me statusin e Kosovës, mirëpo lënia e qytetarëve të Kosovës pa marrë parasysh etninë, në një "geto vizash", kur i gjithë Ballkani, nga Adriatiku e deri në Detin e Zi, do të mund të udhëtojnë lirshëm, është një politikë katastrofale.

Kosova do të kthehet në listën e bardhë

"Liberalizimi i vizave nuk është vetëm çështje e vizave, por është edhe çështje e lëvizjes së lirë në Ballkanin Perëndimor dhe më gjërë, ku Kosova do të jetë e izoluar edhe në çështje tjera integrative", ka thënë ndërkëq kryetari i Klubit për Politikë të Jashtme, Veton Surroi. Sipas tij, fakti që Kosova do të izolohet është një pasiguri, sepse vëtëm ideja për një gjë të tillë krijon ndjenjë negative.

Ndërkëq, Verena Knaus, drejtoreshë ekzekutive e Iniciativës Evropiane për Stabilitet, mendon se procesi i liberalizimit të vizave është një proces që i shqetëson shumë njerëzit në rajon, por edhe në vendet anëtare të BE-së.

Knaus ka përmendur edhe shqetësimet e shpeshtë që artikulohen e ku pyetet pse viktimat e luftës në Bosnjë dhe Kosovë nuk po përfshihen në procesin e liberalizimit të vizave, ndërsa disa të tjerë që kanë bërë krimo po përfshihen në këtë proces. Por, sipas saj, për të pasur një liberalizim të vizave, vendet duhet t'i plotësojnë kriteret teknike të Komisionit Evropian dhe fatkeqësisht Kosova dhe Bosnja nuk i kanë plotësuar. "Mungesa e njohjes nga të gjitha vendet anëtare paraqet një problem tjetër për liberalizimin e vizave. Mirëpo shpresoj se me vë të faktin që Kosova është vendosur në listën e zezë të vizave, me plotësimin e kritereve ajo mund të vendoset në listën e bardhë", ka thënë Knaus.

LLOGARIA E PAGËS

HAPJA E LLOGARISË FALAS

- Përfiton:
- Debit karteli
- Llogari kursimi
- SMS banking
- Mbitërheqje (overdraft) deri në 200% të pagës**
- Urdhëresa automatike

Banka Ekonomike
Traditë dhe siguri